



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AA.nr.2/2022

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Muhamet Rexha dhe Ragip Namani, anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj subjektit hetimor, Sh. A., Prokurore në Prokurorinë Themelore në P., kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (më tej KPK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së prokurores Sh. A., paraqitur përmes të autorizuarit, avokat Artan Qerkini, kundër Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK nr.175/2022, datë 12 Janar 2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24.02.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë, ankesa e Sh. A., Prokurore në Prokurorinë Themelore në P., e paraqitur përmes të autorizuarit, avokat Artan Qerkini, kundër vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK nr.175/2022, datë 12 Janar 2022.

A r s y e t i m

Me vendimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, KPK nr.175/2022, datë 12 Janar 2022, në pikën I të dispozitivit, aprovohet si i bazuar Raporti i Panelit Hetimor, AD.nr. 15/2021, i datës 10.01.2022, në rastin disiplinor të prokurores Sh. A., prokurore në Prokurorinë Themelore në P.. Në pikën II të dispozitivit vërtetohet se, prokurorja Sh. A., ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.10 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në pikën III të dispozitivit, Prokurores Sh. A., i shqiptohet sanksioni disiplinor, Transferim i përhershëm në Prokurorinë Themelore në M., në

Departamentin e Përgjithshëm, sipas nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kundër këtij vendimi, prokurorja Sh. A., përmes të autorizuarit, avokat Artan Qerkini, në afat ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljeve të drejtave procedurale të subjektit në procedurë, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe cenimit të së drejtës në mbrojtje, duke kërkuar që Gjykata Supreme e Kosovës ta pranojë ankesën, ta anulojë Vendimin e KPK-së nr.175/2022, të datës 12.01.2022, dhe prokuroren Sh. A., ta liroi nga përgjegjësia disiplinore ose lëndën ta kthej në rivendosje në KPK.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në përgjigje ndaj ankesës së prokurores, pretendon se ankesa është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, sepse janë zbatuar në tërësi dispozitat e Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, se masa disiplinore është në përputhje me gjetjet e raportit hetimor, është adekuate dhe në proporcion me shkeljen, andaj i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzoi ankesën si të pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të vendimit të atakuar në kuptim të nenit 15 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, më datat 03.08.2021 dhe 05.08.2021, ka pranuar nga Autoriteti Kompetent, Propozimin dhe plotësim propozimin për fillimin e procedurës hetimore disiplinore ndaj Sh. A., prokurore në Prokurorinë Themelore në P., duke propozuar të hetohen veprimet e të njëjtës si dhe t'i shqiptohet masa disiplinore adekuate. Më datë 24.08.2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1, nën paragrafi 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve ka nxjerr vendimin me numër KPK/Nr.611/2021, të datës 24.08.2021, për Themelimin e Panelit Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.15/2021 ndaj prokurores në Prokurorinë Themelore në P., Sh.A..

Më datë 19.11.2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafi 8 të Ligjit Nr. 06/L- 057 për

Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 14 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve ka nxjerr vendimin me numër KPK/Nr.832/2021, i datës 19 nëntor 2021, për zgjatjen e afatit të Panelit Hetimor AD.nr.15/2021 për periudhë kohore shtesë për dy muaj, duke filluar nga data 24.11.2021 deri me datë 23.01.2022.

Më datë 10.01.2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka pranuar nga Paneli Hetimor, Raportin AD.nr. 15/2021, me të cilin ka ardhur në përfundim se prokurorja Sh. A., ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.10 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe dispozitave të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror, sepse e njëjta është përfshirë në sjellje qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e Prokurorit të Shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë dhe besueshmërinë e Prokurorit të Shtetit. Po ashtu, prokurorja A. ka bërë shkelje të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror, shkelje në parimet e përgjithshme si pika 1, pika 3 nën pikat a dhe c dhe pika 5 nën pika k, të këtij Kodi, me rastin e përfshirjes në përgjim të znj. A., në përgjimin e publikuar nga portali Shqip.com i të ashtuquajturës Dosja "Inteligjenca e zhvatjes", me titull: "Ndërhyrje në raste, ushtrim i ndikimit, keqpërdorim i pozitës dhe fotografi të dyshimta – rasti me plotë dritëhije".

Sipas këtij publikimi është dëgjuar një bisedë telefonike e realizuar nga prokurorja Sh. A., me një person të panjohur, N.N. Nga ajo bisedë dëgjohej se bëhet fjalë për një veturë të cilën telefonuesi thotë se ia kanë konfiskuar pa të drejtë, dhe se përgjegjës e bënë Kryeprokurorin e Shtetit. Rasti i tillë penal ku e njëjta veturë ishte konfiskuar nuk ka qenë tek subjekti hetimor por ka qenë në trajtim tek Prokurori i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, z. Sh. K. Për më tej në atë bisedë telefonike dëgjohej qartë fakti se prokurorja A., tregon që ka ndikim të madh brenda sistemit prokurorial dhe do ta përdorë këtë ndikim për të ndërhyrë edhe në rastin e tij. Në bisedën e përgjatur kuptohet se, prokurorja vullnetarisht ka pranuar të flasë me personin NN. Përmes asaj bisede rezulton se personi i panjohur pretendon se di gjëra sekrete për prokurorin A., dhe i shfrytëzon të njëjtat për ta bindur prokurorin në fjalë që t'i ndihmojë në rastin e tij, gjë e cila arrihet pasi që prokurorja A., vazhdon bisedën dhe i premtë personit N.N, që do të interesohet dhe aq sa mundet do të ndikojë në lidhje me rastin e tij.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 12 janar 2022, pasi që ka shqyrtuar raportin e dorëzuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesuesit të Panelit Hetimor i cili ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore si dhe pas dëgjimit të subjektit të hetimit disiplinor, prokurorja Sh. A., së bashku me avokatin Artan Qerkini, e cila në mbrojtjen e saj duke e kundërshtuar raportin në tërësi ka deklaruar se, “biseda e zhvilluar me personin N.N., ka qenë në cilësinë private dhe nuk është dashur të iniciohet procedura disiplinore se është prekur privatësia e garantuar me Kushtetutë. Ajo ka deklaruar se nuk ka pasur qëllim dashakeq. Qëllimi i kësaj bisede ka qenë ta mbrojë institucionin, Kryeprokurorin ta mbroj prej një shantazhuesit”.

KPK-ja konkludon se nga përmbajtja e atyre audio incizimeve të publikuara rezulton fakti që subjekti i këtij hetimi disiplinor, ka pasur kontakte me persona zyrtar të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe të ketë qenë e njohur për çështjen e asaj veture të konfiskuar, ku në një gjendje të tillë faktike e njëjta prokurore së paku do duhej të informonte Kryeprokurorin e zyrës së saj përmes përpilimit të një Shënimi Zyrtar, gjë që e njëjta nuk ka ndërmarr një veprim të tillë.

Paneli Hetimor, për të vërtetuar faktet, raportit ia ka bashkangjitur edhe provat materiale si: transkripton e bisedave që janë bërë në mes subjektit të hetimit dhe personit anonim së bashku me materialet e botuara në gazetën Shqip.com. Paneli Hetimor gjithashtu si pjesë të raportit ka sjell edhe një pjesë të deklaratës se prokurores, audio incizimin dhe transkripton e audio incizimit që gjendet në shkresat e lëndës disiplinore.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli konstatoj se prokurorja Sh. A., ishte përfshirë në bisedat e regjistruara telefonike me bashkëbiseduesin N.N, biseda këto të publikuara në portalin shqip.com, dhe në gazeta dhe portale tjera. Po ashtu, Këshilli ka vlerësuar se komunikimi i prokurores me personin N.N në këtë çështje disiplinore i konsumon të gjitha elementet e shkeljes disiplinore për të cilën është shqiptuar masa disiplinore, Andaj, për rastin e vërtetuar me shkelje serioze, sanksioni disiplinor "Transferim i përhershëm në Prokurorinë Themelore në M., në Departamentin e Përgjithshëm”, është në përputhje me shkeljet e gjetura si në Raportin e Panelit Hetimor, sanksioni i cili do të ketë efekt pozitiv mbi vet prokuroren Asllani që në të ardhmen të veproj konformi rregullave të

Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror. Këshilli ka vlerësuar se sjellja e prokurores Sh. A., përbën shkelje nga neni 6. paragrafi 2 nën paragrafi 2.10, të Ligjit 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse veprimet e saj cilësohen si ndërhyrje në veprimet procedurale të rregullta dhe rrjedhimisht e ka dëmtuar reputacionin e Prokurorisë dhe ka dëmtuar besimin e publikut në besueshmërinë e këtij organi. KPK ka konstatuar se me veprimet e prokurores A., sidomos pas publikimit të përgjimeve është dëmtuar rëndë reputacioni i figurës së prokurorit dhe gjithashtu është dëmtuar rëndë imazhi i sistemit prokurorial. Veprimet e prokurores, janë cenuar parimet bazë të funksionimit të sistemit prokurorial dhe përgjegjësisë që ka për të promovuar vlerat e trajtimit të barabartë të qytetarëve para ligjit dhe para gjykatës, si dhe vlerat që publiku të besoj në ndjekje të paanshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Prokurorial të Kosovës, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar është i ligjshëm dhe është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale kur është vërtetuar përgjegjësia disiplinore e prokurores Sh. A. për shkeljen e Kodit të Etikës, konkretisht nenit 6, paragrafi 2 pika 2.10 i të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe vendimi përkitazi me masën e shqiptuar disiplinore të marrë për këto shkelje në pajtim me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.4, është adekuate dhe proporcionale.

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me qëndrimin se shkeljet e sipër theksuara janë provuar gjatë administrimit të provave, të cilat i janë prezantuar Këshillit, nga raporti fakt mbledhës i Panelit Hetimor, i cili është vlerësuar si raport i besueshëm pasi që në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore Paneli ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve. Siç del nga shkresat e lëndës, Këshilli i ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, përfaqësuesit të tij dhe deklaratën e dëshmitarit, por ka gjetur se në kuptim të fakteve të konstatuara me provat e administruara këto pretendime dhe deklarata nuk kanë ndikuar që Këshilli të marr një vendim tjetër. Ky qëndrim i KPK-së u miratua edhe nga kjo gjykatë për faktin se procedura dhe masa e shqiptuar janë në pajtim me ligjin.

Pretendimi ankimor për cenim të drejtës në mbrojtje nuk u argumentua me asnjë provë. KPK në pajtim me ligjin ka formuar panelin hetimor për të shqyrtuar pretendimet e autoritetit kompetent. Paneli ka zhvilluar hetim në përputhje me ligjin dhe ka administruar procesin duke i

dhënë mundësi deklarimi subjektit hetimor për përgjigje në çdo pretendim. Këshilli më datë 12.01.2022, ka mbajtur seanca dëgjimore, pas pranimit të Raportit nga Paneli Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, me praninë përmes video linkut të subjektit hetimor dhe të autorizuarit të saj. Në pajtim me ligjin është zhvilluar hetimi dhe mbi bazën e këtij hetimi KPK ka shqiptuar masën disiplinore si në dispozitivin e vendimit të atakuar me ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon edhe qëndrimin se masa disiplinore e shqiptuar është proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit dhe është në zbatimin e përgjegjësive ligjore që ka Këshilli Prokurorial në procedurën disiplinore ndaj prokurorëve, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Gjykata Supreme gjeti se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 15 të Ligjit që rregullojnë çështjen e ankimit ndaj vendimeve të KPK-së, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pika 4 e këtij neni parasheh se ankesa ndaj vendimeve të Këshillit mund të ushtrohet në rast të zbatimit të gabuar të Ligjit (4.1) dhe në rast në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës (4.3).

Bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Vendimit të KPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa e subjektit hetimor, e ushtruar ndaj vendimit të KPK-së nuk mbështetet në fakte. Këshilli Prokurorial i Kosovës ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është dëshmuar se është bërë shkelje disiplinore nga parashtruesja e ankesës, dhe të njëjtës i ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe ka marrë parasysh edhe seriozitetin, pasojat, rrethanat në të cilat është kryer shkelja. Prandaj pretendimet e ankesës për aplikim të gabuar të së drejtës materiale janë të pa bazuara dhe si të tilla u refuzuan.

Duke qenë se sipas Kodit të Etikës për Prokuror, prokurori gjatë gjithë kohës, në të gjitha rrethanat duhet të veproj në atë mënyrë që të nxisë besimin e publikut në dinjitet, integritet, efektivitet dhe paanshmëri, në të gjitha rrethanat, në detyrë dhe në jetën private duhet që t'i respektojë standardet e larta të sjelljes profesionale dhe personale, t'i kryejë detyrat ne paanshmëri dhe kujdes, të shmangë çdo sjellje dhe situatë që mund të vërë në pikëpyetje integritetin, paanshmërinë dhe profesionalizmin, të respektojë dhe t'i përmbahet ligjit, t'i kryej

detyrat bazuar në standardet e njohura ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, prokurorja Shemsije Asllani ka dëmtuar reputacionin e Prokurorit të Shtetit.

Prokurorja A., ka pas funksion publik dhe nuk ka qenë e ngarkuar me lëndën penale ku ka qenë e përfshirë bashkëbiseduesi. Po ashtu, gjatë bisedës së zhvilluar nuk ka bërë ndonjë Shënim Zyrtar, prandaj komunikimi i zhvilluar i Prokurores së Shtetit, znj. Sh. A., me personin e panjohur, pa menduar fare për rëndësinë e funksionit që e ushtron ka kontribuar në dështim dhe cenim të integritetit të saj dhe të institucionit që e përfaqëson.

Pretendimi i paraqitësit të ankesë se ndaj prokurores janë shkelur të drejtat e njeriut për shkak të përgjimit, me të cilin pretendohet se është cenuar privatësia, u shqyrtua nga Gjykata Supreme por u gjet se është i pa bazuar dhe nuk është objekt shqyrtimi në këtë procedurë. Ushtrimi i funksionit të prokurorit të shtetit është me interes të lartë publik dhe si i tillë çdo informacion që lidhet me ushtrimin e këtij funksioni i nënshtrohet edhe interesit publik dhe si i tillë nuk mund të përkufizohet si shkelje e privatësisë. Praktika e Gjykatës Evropiane të Drejtave të njeriut në shumë raste ka vendosur në interes të publikut në raste të publikimit të informacioneve që lidhen me individët e posaçërisht me punën dhe veprimtarinë e tyre publike. Prandaj Gjykata Supreme e Kosovës nuk e aprovon pretendimin ankimor se ka pasur shkelje të privatësisë të subjektit hetimor, sepse si parim, publikimi në rastin konkret nuk ka të bëjë me çështje strikte private që do të cenonin të drejtën e respektimit të jetës private, sepse publikimi i tillë konsiderohet me interes të publik, siç është ushtrimi i funksionit të prokurorit të shtetit sipas ligjit. Nga ana tjetër, rast se pretendohet se ky publikim i informacionit është bërë në mënyrë të paligjshme kjo nuk është objekt shqyrtimi i kësaj gjykate sepse çështja mund të ndiqet në procedurë adekuate penale, kurse sa i përket rastit konkret, vetë involvimi i subjektit hetimor në këtë bisedë, ajo çka thuhet dhe premtohet si dhe publikimi i këtyre informatave, paraqesin bazë të mjaftueshme për inicim të procedurës disiplinore dhe si zbatim dhe përfundim i kësaj procedure, vendimi i KPK-s në këtë drejtim është në përputhje me ligjin.

Mbi bazën e dëgjimit të dy pjesëve të audio-incizimeve të sipër cekura e të publikuara në opinionin publik përmes portalit SHQIP.com, e ashtuquajtura dosja "Inteligjenca e zhvatjes", nga vetë përmbajtja-deklarimet e shprehura në ato audio-incizime nga ana e Prokurores së Shtetit, znj. Sh. A., gjatë bisedës telefonike me personin N.N., ku e njëjta i referohet personit N.N., se do të bëjë çmos që të i ndihmoj atij për çështjen e asaj veture të konfiskuar, në mënyrë

që me kujdes të shtuar të kontaktoj me prokurorin e çështjes, z. Sh. K., dhe të kuptoj se si qëndron çështja e statusit të asaj veture dhe se do të rrezikoj veten lidhur me këtë rast për interes të personit N.N.. gjithë këtë pasi që personi N.N., i kishte treguar asaj se për të kishte njohuri se një person i inteligjencës së një shteti të huaj kishte fotografi komprometuese. Këto janë sjellje në kundërshtim me ligjin.

Edhe pretendimet e palës ankuese për zbatim të gabuar të Kodit të Etikës profesionale për gjyqtarë nuk u aprovua nga kjo gjykatë për faktin se në arsyetimin e dhënë nga KPK është bërë aplikim i drejtë i dispozitës së nenit 6 paragrafi 2, të Ligji nr. 06/l - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku përcaktohet se: “Shkelje e detyrave të prokurorit, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se prokurori i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë:”. Ndërsa në paragrafi 2.10 përcaktohet se: “ prokurori përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e prokurorit të shtetit ose që mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e prokurorit të shtetit;”.

Prandaj nëse i referohemi dispozitave përkatëse ndërhyrja në veprimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë me qëllim të ndikimit në aktivitetet dhe vendimet e tyre në çfarëdo mënyre të ndaluar me ligj, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e Prokurorisë së shtetit ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë, del qartazi se prokurorja subjekt i hetimeve, e ka konsumuar shkeljen për të cilën ngarkohet dhe sanksioni disiplinor është në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 4 të njëjtij ligj i cili parasheh edhe sanksionin disiplinor "Për shkelje disiplinore, Këshillat përkatës mund t'u shqiptojnë gjyqtarëve dhe prokurorëve një ose më shumë nga sanksionet disiplinore" ndërsa në paragrafin 1.4. parashihet edhe masa "transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ulët".

Prandaj sipas Gjykatës Supreme të Kosovës është zbatuar procedura e paraparë sipas ligjit në fuqi dhe masa e dhënë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh: seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga prokurorja, pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; Ky sanksion disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor ashtu siç parashihen në nenin 7 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve



dhe Prokurorëve. Prandaj, pretendimet në ankesë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuan asnjërën nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa dhe nuk kanë bazë në nenin 15, pika 4.1 deri pika 4.3 të Ligjit, gjegjësisht nuk u gjet zbatim i gabuar i ligjit, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 15.6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.2/2022 më 24.02.2022

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami